



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 4 par 3 dhe 27 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr. 011-70915 e datës 28.12.2016, Vendimit të Kuvendit të Komunës për përcaktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan për mbulimin e shpenzimeve të varrimit 15Nr.400-45612 i datës 12.11.2014 si dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 30. 04. 2018, pas shqyrtimit të propozimit të kryetarit miratoi këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË
ISLAME NË LIPJAN

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej 9570 €, (nëntëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë euro), për subvencionimin – mbulimin e shpenzimeve të varrimeve për 87 raste të vdekjes, me nga 110 Euro për secilin rast $87 \times 110 = 9570$.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës .

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 400 - 28040
Lipjan, më 02. 05. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

